



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Bart

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 22 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër drejtuar Policisë së Kosovës

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Holling

Valeria Boliçi

Xhejmz Paçe

Mbrojtësve të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

T'i dorëzohet

Policisë së Kosovës

Mbrojtësve të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

TRUPI GJYKUES II, në pajtim me nenet 1(2), 2, 3(2)(e), 19(2), 21(3) 40-41 dhe 53(1) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 57(2), 116(1), (4)(d) dhe 202 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 shtator 2020, Hysni Gucati ("z. Gucati") dhe Nasim Haradinaj ("z. Haradinaj") (bashkërisht, "të akuzuarit") u arrestuan në lidhje me shpërndarjen e pretenduar të informacionit konfidencial dhe jopublik lidhur me punën e Task Forcës Hetimore Speciale ("TFHS") dhe/ose të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS").¹
2. Më 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm refuzoi kërkesat e të akuzuarve për lirim të përkohshëm.² Gjykatësi i Procedurës Paraprake rishikoi dhe zgjati paraburgimin e tyre në intervale të rregullta, përkatësisht më 24 dhjetor 2020, 24 shkurt, 23 prill dhe 23 qershor 2021.³

¹ F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020; F00015, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit Sipas Rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020; F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020; F00018, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Hysni Gucatis në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, me Shtojcën 1, konfidenciale.

² F00058, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim në Lidhje me Kërkesën për Lirim të Menjëhershëm të Nasim Haradinajt*, 27 tetor 2020; F00059, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani*, 27 tetor 2020.

³ F00093, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatis*, 24 dhjetor 2020; F00094, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 24 dhjetor 2020; F00143, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatis*, 24 shkurt 2021; F00144, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 24 shkurt 2021; F00188, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatis*, 23 prill 2021; F00189/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 23 prill 2021; F00245, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatis*, 23 qershor 2021; F00246, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 23 qershor 2021.

3. Më 16 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes gjyqësore Trupit Gjykses II ("Trupi Gjykses").⁴ Më 23 gusht 2021,⁵ Trupi Gjykses e rishikoi dhe zgjati paraburgimin e të akuzuarve

4. Më 15 tetor 2021, Mbrojtja e z. Gucati kërkoi që z. Gucati të lirohet sipas një sërë kushtesh të propozuara që përfshijnë Policinë e Kosovës ("kushtet e propozuara").⁶

5. Më 22 tetor 2021, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Gucati dhe z. Haradinaj, duke theksuar se do të kërkonte informacion nga Policia e Kosovës në lidhje me zbatueshmërinë e kushteve të propozuara për dy të akuzuarit dhe se do të rishqyrtonte paraburgimin e tyre pas marrjes së këtij informacioni.⁷

II. PARASHRITIMET

6. Mbrojtja e z. Gucati kërkon që z. Gucati të lirohet sipas kushteve të propozuara në vijim: (i) që z. Gucati të vendoset në arrest shtëpiak në adresën e tij të banimit dhe që një anëtar i Policisë së Kosovës të mbikëqyrë gjatë gjithë kohës personat që hyjnë ose dalin nga ajo adresë (qoftë personalisht ose në distancë me anë të një kamere sigurie); (ii) që z. Gucati t'i ndalohej të largohet nga adresa e banimit të tij në çfarëdo kohe, përveç në rast të ndonjë urgjence mjekësore ose urgjence tjetër dhe, në raste të tilla, ai të jetë gjatë gjithë kohës nën ruajtjen fizike të një oficeri policie deri në kthimin e tij; (iii) që gjatë gjithë kohës, brenda adresës së tij të banimit të mos lejohet të përdoret asnjë telefon, pajisje telekomunikimi ose pajisje e përdorshme përmes internetit; (iv) që adresa e banimit të z. Gucati të

⁴ F00265, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Trupit Gjykses II*, 16 korrik 2021.

⁵ F00279, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 23 gusht 2021; F00280, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 23 gusht 2021.

⁶ F00375, Mbrojtja e Gucatit, *Parashtrime në Lidhje me Rishikimin e Gjashtë të Paraburgimit ("Parashtrimi i Gucatit")*, 15 tetor 2021, para. 13.

⁷ F00390, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 22 tetor 2021; F00391, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 22 tetor 2021.

kontrollohet përpara mbërritjes së tij për të parë nëse ka të fshehur ndonjë telefon, pajisje telekomunikimi ose pajisje të përdorshme përmes internetit. Shtëpia do të kontrollohet sërish pas hyrjes së tij dhe më pas në mënyrë rastësore; (v) që të vetmit persona që do të lejohen të hyjnë në atë adresë, përveç familjes së ngushtë të z. Gucati (gruaja dhe fëmijët) dhe oficerëve të policisë, do të jenë personat, emrat e të cilëve figurojnë në një listë të miratuar paraprakisht të anëtarëve të familjes, dhe persona të tjerë që kanë të drejtë ta vizitojnë atë në adresën e banimit të tij, me miratimin paraprak të Trupit Gjykses. Do t'i ndalohet hyrja çdo personi që nuk verifikohet se është në listën e miratuar paraprakisht të vizitorëve që lejohen të kryejnë vizita; (vi) që vizitat në adresën e banimit të z. Gucati, të personave të lartpërmendur të miratuar paraprakisht, të koordinohen paraprakisht nëpërmjet njoftimit të Policisë së Kosovës; (vii) që çdo personi që hyn në shtëpi t'i kërkohet të dorëzojë telefonat, pajisjet e telekomunikimit ose pajisjet e përdorshme përmes internetit përpara se të hyjë aty; (viii) që çdo person (përfshirë anëtarët e familjes) që hyn në atë shtëpi të pajtohet me monitorimin pasues të telefonave, pajisjeve të telekomunikimit ose pajisjeve të përdorshme përmes internetit të tyre për aq kohë sa zgjat periudha e lirimit të përkohshëm të z. Gucati; (ix) që çdo person që hyn ose del nga shtëpia të kontrollohet nëse ka me vete ndonjë telefon, pajisje telekomunikimi ose pajisje të përdorshme përmes internetit, mesazh me shkrim ose dokument tjetër; (x) që Policia e Kosovës të kryejë kontrole të rastësishme në adresën e banimit të z. Gucati për të verifikuar nëse z. Gucati, anëtarët e familjes së tij dhe/ose personat që e vizitojnë atë po u përmbahen kushteve të lartpërmendura të lirimit dhe që, në veçanti, nuk kanë telefona, pajisje telekomunikimi ose pajisje të përdorshme përmes internetit në adresën në fjalë; (xi) që Policia e Kosovës të njoftojë menjëherë Zyrën Administrative nëse konstatohet se z. Gucati, ndonjë nga anëtarët e familjes së tij ose ndonjë nga

personat që e vizitojnë atë në adresën e banimit të tij, kanë shkelur kushtet e lartpërmendura të lirimit.⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Sipas nenit 41(6)(a) dhe (b) të Ligjit, Dhomat e Specializuara urdhërojnë paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer një vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara; dhe ekzistojnë arsye të artikulueshme të besohet se: (i) ekziston rreziku i arratisjes; (ii) se personi do të pengojë ecurinë e procesit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë vepër penale në tentativë, ose do të kryejë ndonjë vepër penale që personi ka kërcënuar se do ta kryejë.

8. Neni 41(12) i Ligjit parashikon masa alternative për parandalimin ose zvogëlimin e këtyre rreziqeve, duke përfshirë, ndër të tjera, dorëzaninë, arrestin shtëpiak, premtimin për të mos u larguar nga vendbanimi dhe ndalimin për t'iu afruar vendeve ose personave të caktuar.

9. Sipas nenit 53(1) të Ligjit dhe rregullës 202 të Rregullores, duke mbajtur parasysh të drejtat e të akuzuarit të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë bashkëpunojnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyren e Prokurorit të Specializuar dhe përmbushin pa vonesë çdo kërkesë për ndihmë, urdhër ose vendim të nxjerrë nga Dhomat e Specializuara apo Zyra e Prokurorit të Specializuar.

IV. DISKUTIM

10. Duke mbajtur parasysh kushtet e propozuara dhe pa cenuar asnjë vendim që mund të marrë Trupi Gjykses në lidhje me kushtet e paraburgimit të akuzuarit, Trupi Gjykses urdhëron Policinë e Kosovës të dorëzojë, siç përcaktohet në

⁸ Parashtrimi i Gucatit, para. 13.

Shtojcën e këtij Urdhri, informacion në lidhje me: (i) autoritetin dhe kapacitetin e Policisë së Kosovës (veçanërisht për sa i përket personelit dhe burimeve që ka në dispozicion) për të kufizuar lëvizjet e individëve subjekte të lirit të përkohshëm, për të monitoruar dhe kufizuar komunikimet e këtyre individëve, për të administruar arrestin shtëpiak dhe për të garantuar zbatimin e njëjtë të masave të lartpërmendura gjatë shtrimit në spital; (ii) zbatueshmërinë e masave të lartpërmendura që shoqërojnë lirin e përkohshëm; dhe (iii) raste të mëparshme të zbatimit të masave të tilla që shoqërojnë lirin e përkohshëm të personave të akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, në veçanti për vepra penale sipas neneve 387, 388, 392 dhe 401 të Kodit Penal të Kosovës. Gjithashtu, Policia e Kosovës mund të dorëzojë çdo informacion tjetër shtesë që gjykon se ka lidhje me zbatimin e lirit me kusht.

11. Policia e Kosovës të bashkëpunojë me departamente dhe/ose autoritete të tjera të Kosovës në qoftë se është e nevojshme për dhënien e informacionit të kërkuar. Çdo pengesë teknike, logjistike ose e një natyre tjetër që pengon zbatimin e duhur të këtij Urdhri, i duhet bërë menjëherë e ditur Trupit Gjykses.

V. VENDIM

12. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **URDHËRON** Administratoren t'ia përcjellë këtë Urdhër dhe Shtojcën e tij Policisë së Kosovës, sapo të vihet në dispozicion përkthimi i tij në gjuhën shqipe;
- b. **URDHËRON** Policinë e Kosovës që të respektojë konfidencialitetin e Shtojcës dhe të përmbajtjes së saj; dhe
- c. **URDHËRON** Policinë e Kosovës që, në bashkëpunim me departamente dhe/ose autoritete të tjera të Kosovës në qoftë se është e nevojshme, të

dorëzohet informacionin e përcaktuar në Shtojcën e këtij Urdhri deri më
26 nëntor 2021.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 22 tetor 2021

Në Hagë, Holandë